



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dërguar Punimend/Pradato Received/Delivered	30	11	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	SKDM SHK	7139	2023	Sasia Kolicina Quantity
				1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1294/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me numër A.nr.1294/2023 të datës 17.10.2023 të parashtruar nga ankuesi të cilën me autorizim e përfaqëson Avokatura Bokshi-Ylli Bokshi, kundër Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 30.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1294/2023 të datës 17.10.2023 të parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 17.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshullin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është e regjistruar nën shenjë A.nr.1294/2023 dhe me numër të protokollit: 6561/2023, kundër Vendimit me nr.prot. 2589 të datës 05.09.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (tani e tutje SHSKUK) dhe kundër Vendimit me nr.prot.2925 të datës 22.09.2023 të Komisionit të Ankesave të SHSKUK-së, me pretendim ankimor për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale me kërkesën që Këshilli të anuloi Vendimin me nr.prot.2589 të datës 05.09.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Vendimin me nr.prot.2925 të datës 22.09.2023 të Komisionit të Ankesave të SHSKUK-së duke e kthyer ankuesin në pozitën e Drejtorit të Spitalit Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas kontratës së datës 07.06.2022 me numër:034 ka të themeluar marrëdhënien e punës me kohë të caktuar dhe atë në pozitën "Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë" nga data 09.06.2022 deri me datë 08.06.2023, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së përmes Vendimit të datës 05.09.2023 me nr.prot.2589 ia ka ndërprerë ankuesit kontratën e punës së datës 07.06.2022 si në pikën I të dispozitivit të aktit të goditur, kurse sipas pikës II të dispozitivit të njëjtit akt, ankuesi është kthyer në pozitën mjek specialist Kirurg i Fëmijëve në Repartin e Kirurgjisë në Spitalin e Përgjithshëm "Isa Grezda" në Gjakovë.

Ankuesi, kundër Vendimit të datës 05.09.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së, sipas këshillës së dhënë juridike ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave, ndërsa komisioni i ankesave përmes Vendimit me nr.prot. 2925 të datës 22.09.2023 e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 12.09.2023 ndërsa e ka lënë në fuqi Vendimin me nr.prot. 2589 të datës 05.09.2023 të Drejtorit i Përgjithshëm SHSKUK -së, duke ia dhënë këshillën juridike ankuesit si në vijim, **citohet**: "pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të iniciojë kontest në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditë, nga dita e pranimit i këtij vendimi".

Me qëllim të konstatimit të kompetencës në këtë çështje, Kolegji i Këshillit iu referuar Ligjit Nr.06/L-114 Zyrtarët Publik i cili ka qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së akteve të kontestuara e ku sipas nenit 2 paragrafi 2 dhe 4 përcaktohet se: "2 . Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.", dhe ka ardhur në përfundimin se sipas kontratës së datës 07.06.2022 me numër:034 ankuesi ka pas të themeluar marrëdhënien e punës me kohë të caktuar dhe atë në pozitën Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë, respektivisht pozita që mban ankuesi hynë në kuadër të kategorisë *Nëpunës i Shërbimit Publik* sipas nenit 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 Zyrtarët Publik, gjegjësisht pozita Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë, nuk është pozitë që hynë në kuadër të kategorisë së nëpunësve të Shërbimit Civil ngase përmes veprimtarisë së pozitës që ka mbajtur ankuesi ofrohen shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në *fushën e shëndetësisë* sikurse përcaktohet me paragrafin 4 të nenit 2 të njëjtit ligj të potencuar si më lartë, andaj duke marr për bazë nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas të cilit nen përcaktohet se Këshilli ka kompetencë të shqyrtoj dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, arrihet në konstatimin se Këshilli nuk është kompetentë për të shqyrtuar ankesën e ankuesit Jeton Zarari të datës 17.10.2023 ngase i njëjti nuk e ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil.

Kolegji i Këshilli, po ashtu iu referua nenit 74 paragrafi 1, 4 dhe 5 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr.06/L-114 Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "1. Zyrтари i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankimit e kanë dhe kandidatët në procedurën e konkurrimit. 4. Ankesa shqyrtohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga

paraqitja e saj. 5. Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente” dhe ka ardhur në përfundimin se Vendimi me nr.prot.2589 i datës 05.09.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së ka përmbajtur këshillën e dhënë juridike sikurse përcaktohet me paragrafin 1 dhe 4 të nenit 74 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr.06/L-114 Zyrtarët Publik, dhe po ashtu këshillën juridike apo udhëzimin në mjete juridike e ka përmbajtur edhe Vendimi me nr.prot.2925 i datës 22.09.2023 i Komisionit të Ankesave të SHSKUK-së sipas paragrafit 5 të nenit 74 të Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 Zyrtarët Publik, prandaj Kolegji i Këshillit me rastin e shpalljes së jo kompetencës në trajtimin e kësaj lënde nuk sheh arsye ligjore që në kuptim të nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesën e ankuesit të adresojë tek organi kompetentë, ngase ankuesi ka qenë i udhëzuar drejtë përmes këshillës së dhënë juridike sipas vendimit me nr.prot.2925 të datës 22.09.2023 të Komisionit të Ankesave të SHSKUK-së,se i njëjti/ankuesi mund të hap kontest pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, mirëpo ankuesi nuk ka vepruar konformë këshillës së dhënë juridike dhe i njëjti ka parashtruar ankesë në Këshilli e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.1294/2023,datë 30/11/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit,
- Komisionit të Ankesave të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

